

Në bazë të nenit 18 paragrafi 1 alineja 8 dhe neni 20 paragrafi 1 alineja 11, në lidhje me nenin 67 paragrafi 1 dhe paragrafi 11, dhe neni 80 paragrafi 2 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14 dhe 132/14), dhe neni 15 paragrafi 1 alineja 7 dhe neni 39 paragrafi 1 alineja 3 nga Rregullorja e punës së Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele nr. 01-4351/1 nga 29.08.2014, në pajtim me Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë nr. 02-5747/4 nga data 21.11.2014, Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, në mbledhjen e 19-të të mbajtur më 21.11.2014, miratoi

RREUGLLORE PËR FORMATET E SHËRBIMEVE PROGRAMORE TË RADIODIFUZERËVE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Lënda e Rregullores

Me këtë Rregullore përcaktohen formatet e shërbimeve programore të radiodifuzerëve, mënyra e përcaktimit të tyre, si dhe vlerat e koeficientit K_n për llojet e ndryshme të formateve.

Neni 2

Qëllimet e Rregullores

Qëllimi i kësaj Rregullore është që të sigurohet zbatimi i dispozitave të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, sidomos në drejtim të:

- Mbrojtjes dhe zhvillimit të pluralizmit dhe inkurajimit, si dhe përkrahjes së ekzistimit të shërbimeve të shumëllojshme, të pavarura audio dhe audiovizuele (neni 6); dhe
- publikimi i lejes për emetim radio ose televiziv (sidomos nenet 70, 71, 73, 74, 75, 78, 80).

II. FORMATI I SHËRBIMEVE PROGRAMORE TELEVIZIVE

Neni 3

Mënyra e përcaktimit të TV formateve

Formatet e shërbimeve të programeve televizive përcaktohen në bazë të përfaqësimit të llojeve të programeve dhe funksioneve mediatike audiovizuele (informative, arsimore ose argëtuese) që ata e plotësojnë në programin e përgjithshëm të emetuar gjatë një jave.

Nga programi i emetuar në përgjithësi gjatë një jave përjashtohet koha për: Komunikime komerciale audiovizuele, publikime të radiodifuzerit në lidhje me programet e tija personale,

deklarata me interes publik, apele për qëllime humanitare, intermexo, shërbime dhe liturgji fetare, programe për kulturë fizike dhe rekreacion, xhingla dhe avizo (pika 17 nga Udhëzimi për mënyrën e klasifikimit të llojeve të programeve audiovizuele dhe atyre të audios¹).

Neni 4 **Llojet e TV formateve**

Formati i shërbimeve programore televizive mund të jetë i përgjithshëm ose i specializuar.

Shërbimi i programit televiziv i formatit të përgjithshëm është shërbim që përmban lloje të ndryshme të programeve audiovizuele që kryesisht plotësohet njëra ose të gjitha tre funksionet mediale (informative, arsimore ose argëtuese).

Shërbimi programor televiziv në format të specializuar është shërbim që dominon me përmbajtje të një llojit të caktuar të programit audiovizuel.

Neni 5 **Shërbimet programore televizive në format të përgjithshëm**

Shërbimet programore televizive në format të përgjithshëm duhet patjetër të ketë së paku 5 (pesë) nga llojet e programeve audiovizuale të përcaktuara në pikat 8, 10 dhe 12 nga Udhëzimi për mënyrën e klasifikimit të llojeve të programeve të audios dhe audiovizuele.

Shërbimet programore televizive në format të përgjithshëm mund të jenë:

- me të gjitha tre funksionet mediatike,
- me një format kryesisht të përgjithshëm arsimor,
- Me një format kryesisht të përgjithshëm informativ, dhe
- me një format kryesisht të përgjithshëm argëtues.

Neni 6 **Shërbimi i formatit të përgjithshëm me të gjitha tre funksionet mediatike**

Në shërbimin e programit televiziv të formatit të përgjithshëm, në të cilin llojet e përfaqësuara të programeve i plotësojnë të gjitha tre funksionet mediatike, cdo funksion duhet patjetër të përfaqësohet me së paku 30% nga programi i emituar në përgjithësi gjatë një jave.

Neni 7 **Shërbimi i formatit të përgjithshëm që kryesisht plotëson një funksion**

Në shërbimin programor televiziv të formatit të përgjithshëm ku llojet e vjetruara të programeve kryesisht plotësojnë njërin prej tre funksioneve mediatike, funksionin që kryesisht e plotësojnë nuk guxon që të jetë i përfaqësuar me më pak se 50%, e as më shumë se 65%. Pjesa tjetër e programit përbëhet nga programe që i plotësojnë dy funksionet tjera mediatike, me c'rast njëra prej këtyre funksioneve nuk guxon që të përfaqësohet me më pak se 5% nga programi i emituar në përgjithësi gjatë një jave.

¹ Udhëzimi për mënyrën e klasifikimit e llojeve të programeve audio dhe audiovizuele ku referohet në nenet 3, 5, 9 dhe 11 nga kjo Rregullore është publikuar në "Gazetë zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 171/14

Neni 8
Shërbimet programore televizive në format të specializuar

Shërbimi programor televiziv i formatit të specializuar patjetër duhet të përmbajë së paku 70% nga një lloj i programit audiovizuel në programin e emetuar në përgjithësi gjatë një seance.

Lloji i programit audiovizuel mund të plotësohet me cilin do funksion mediatik (informativ, arsimor ose argëtues).

III. FORMATI I SHËRBIMEVE PROGRAMORE TË RADIOS

Neni 9
Kriteret për përcaktimin e formateve të radios

Formatet e shërbimeve të programit të radios përcaktohen sipas dy kriterëve:

- Sipas përfaqësimit të përmbajtjeve në programin e emetuar në përgjithësi gjatë një jave, pa kohën e ndarë për përmbajtjet që nuk i nënshtrohen klasifikimit; Komunikime komerciale audiovizuale, publikime të radiodifuzerit në lidhje me programet e tija personale, deklarata me interes publik, apele për qëllime humanitare, intermexo, shërbime dhe liturgji fetare, programe për kulturë fizike dhe rekreacion, xhingla dhe avizo (pika 17 nga Udhëzimi për mënyrën e klasifikimit të llojeve të programeve audiovizuale dhe atyre të audios).
- Sipas strukturës së përmbajtjeve dhe llojit të programeve të audios dhe funksioneve mediatike që ato i plotësojnë, respektivisht sipas strukturës së muzikës së emetuar sipas llojit dhe zhanrit.

Neni 10
Mënyra e përcaktimit të formateve të radios

Varësisht nga përfaqësimi i përmbajtjeve në programin e emetuar në përgjithësi gjatë një jave, pa kohën e ndarë për përmbajtjet që nuk i nënshtrohen klasifikimit, radiot ndahen në katër grupe:

- radio biseduese; Mbi 25% me përmbajtje të bisedave;
- Radio biseduese – muzikore; Mbi 15% deri në 25% përmbajtje të bisedave;
- Radio muzikore – biseduese: Mbi 5% deri në 15% përmbajtje të bisedave; dhe
- Radio muzikore; Deri në 5% me përmbajtje të bisedave;

Formati të radiot biseduese dhe biseduese - muzikore përcaktohet sipas përfaqësimit të llojeve të audio programeve dhe funksioneve që ato i plotësojnë në përmbajtjet e emetuara biseduese gjatë një jave.

Formati të radiot muzikore-biseduese dhe radiot muzikore përcaktohet sipas strukturës së muzikës së emetuar në përgjithësi sipas llojit dhe zhanrit gjatë një jave.

Neni 11 Llojet e formateve të radios

Formati i shërbimeve programore të radios mund të jetë i përgjithshëm ose i specializuar.

Radio biseduese dhe biseduese-muzikore në format të përgjithshëm janë shërbimet programore që përmbajnë 3 (tre) prej llojeve të audio programeve të përcaktuara në pikat 8, 10 dhe 12 nga Udhëzimi për mënyrën e klasifikimit të llojeve të programeve audio dhe audiovizuale, me ç'rast llojet e programeve plotësojnë së paku dy ose kryesisht një funksion mediatik (informativ, arsimor ose argëtues).

Radiot biseduese ose biseduese – muzikore në format të specializuar janë shërbime programore që kryesisht përmbajnë një lloj të audio programit.

Radiot Muzikore-biseduese dhe ato muzikore në format të përgjithshëm janë shërbimet programore të cilat programi i emetuar është i llojeve të ndryshëm të zhanreve muzikore dhe ku asnjë lloj muzike nuk dominon.

Radiot Muzikore-biseduese dhe ato muzikore në format të përgjithshëm janë shërbimet programore të cilat programe të emetuar dominon vetëm një lloj.

Neni 12 Klasifikimi i muzikës sipas llojeve dhe zhanreve

Për nevojat e kësaj Rregullore, muzika e emetuar të shërbimet programore të radios klasifikohet në 4 (katër) lloje: popullore, popullarizuar (argëtuese), klasike dhe shpirtërore. Klasifikimi i muzikës është bërë në pajtim me Klasifikimin nacional të trashëgimisë kulturore ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 37/06) dhe Klasifikimi universal decimal.

Secili lloj i muzikës përmban më shumë zhanre muzikore:

1. Muzika popullore:

- Tradicionale: Muzikë burimore-të paautorizuar;
- Etno/World music;
- Muzikë popullore e sapokrijuar (muzikë popullore e sapokomponuar): Muzikë popullore e sapokrijuar në frymën popullore, turbo folk, disko folk, pop folk.

2. Muzikë e popullarizuar (argëtuese):

- Pop: disco, dance, hip hop, pop rock, rhythm and blues (R&B), soul, funk, rap, reggae, ska, dub etj;
- Xhaz: ragtime, dixieland, swing, be-bop, hard-bop, cool jazz, free jazz, fusion, smooth jazz, acid jazz etj;
- Bluz;
- Rok/ Rokënrol; rockabilly, acid rock, hard rock, punk, folk rock, psychedelic rock; progressive rock, heavy metal, new wave, hard rock, alternative rock, grunge, britpop, indie rock, soft rock etj;
- Muzikë elektronike/Tekno: house, acid, goa, trance, jungle, drum etj;

3. Muzikë klasike:

- Mesjetare, renesancës, barokut, rokokosë, klasika, romantizmit, impresionizmit, ekspresionizmit, etj.

4. Muzika shpirtërore:

- Ortodokse, katolike, protestante, herreje, islame, budiste, hindus, gospel - rituale të zezakëve, mantri etj;

Neni 13

Llojet e radiove biseduese dhe biseduese-muzikore të formatit të përgjithshëm

Radiot biseduese dhe biseduese-muzikore në format të përgjithshëm mund të jenë:

- me së paku dy funksione mediatike;
- me format kryesisht arsimor;
- me format të përgjithshëm kryesisht informativ; dhe
- me format të përgjithshëm kryesisht argëtues.

Neni 14

Radio biseduese dhe biseduese-muzikore në format të përgjithshëm me së paku dy funksione

Tek radiot biseduese dhe biseduese-muzikore të formatit të përgjithshëm, te të cilat përmbajtjet biseduese të programit plotësohen së paku dy funksione mediatike, e asnjë funksion mediatik nuk guxon të përfaqësohet me më shumë se 50% të pjesës biseduese të programit gjatë një jave.

Neni 15

Radio biseduese dhe biseduese-muzikore në format të përgjithshëm me së paku dy funksione

Tek radiot biseduese dhe biseduese-muzikore të formatit të përgjithshëm, te të cilat përmbajtjet biseduese të programit plotësojnë së paku një funksion mediatike, e asnjë funksion mediatik nuk guxon të përfaqësohet me më shumë se 50% të pjesës biseduese të programit gjatë një jave.

Neni 16

Radiot biseduese dhe biseduese-muzikore të formatit të specializuar

Radiot biseduese dhe biseduese-muzikore të formatit të specializuar janë shërbime programore që përmbajnë së paku 70% të një lloji të audio programit në përmbajtjet e përgjithshme të emetuara gjatë një jave.

Neni 17

Radio muzikore-biseduese të formatit të përgjithshëm

Radiot muzikore-biseduese dhe ato muzikore në format të përgjithshëm janë shërbime programore te të cilat programi i emtuar është i llojeve të ndryshëm të zhanreve muzikore dhe ku asnjë lloj muzike nuk është përfaqësuar me 70% nga muzika e emtuar në përgjithësi gjatë një jave.

Neni 18
Radio muzikore-biseduese të formatit të specializuar

Radiot muzikore-biseduese dhe ato muzikore në format të specializuar janë shërbimet programore të cilat një lloj i muzikës është përfaqësuar me 70% nga muzika e emetuar në përgjithsi gjatë një jave.

IV. KOEFICIENTI K_n

Neni 19
Koeficienti K_n për shërbimet televizive

Koeficienti K_n për shërbimet programore televizive të formatit të përgjithshëm është:

- 0,80 për TV shërbim me të gjitha tre funksionet mediatike.
- 0,85 për TV shërbim me format kryesisht arsimor;
- 0,95 për TV shërbim me format kryesisht informativ të përgjithshëm;
- 1,00 për TV shërbim me format kryesisht argëtues të përgjithshëm;

Koeficienti K_n për shërbimet programore televizive të formatit të specializuar është:

- 1,20 për TV shërbim të cili lloji dominues i programit ka funksion arsimor,
- 1,35 për TV shërbim të cili lloji dominues i programit ka funksion informativ,
- 1,50 për TV shërbim të cili lloji dominues i programit ka funksion argëtues.

Neni 20
Koeficienti K_n për radio biseduese dhe biseduese muzikore

Te radiot biseduese dhe ato biseduese-muzikore të formatit të përgjithshëm, koeficienti K_n është:

- 0,80 për radio biseduese dhe biseduese-muzikore me së paku dy funksione mediatike.
- 0,85 për radio biseduese dhe biseduese-muzikore me format kryesisht arsimor të përgjithshëm
- 0,90 për radio biseduese dhe biseduese-muzikore me format kryesisht informativ të përgjithshëm
- 1,00 për radio biseduese dhe biseduese-muzikore me format kryesisht të përgjithshëm

Te radiot biseduese dhe ato biseduese-muzikore të formatit të specializuar, koeficienti K_n është:

- 1,15 për radio biseduese dhe biseduese-muzikore të e cila lloji dominues i programit ka funksion arsimor,
- 1,25 për radio biseduese dhe biseduese-muzikore të e cila lloji dominues i programit ka funksion informativ,
- 1,35 për radio biseduese dhe biseduese-muzikore të e cila lloji dominues i programit ka funksion argëtues,

Neni 21

Koeficienti Kn për radio biseduese dhe biseduese muzikore

Te radiot biseduese-muzikore dhe ato muzikore të formatit të përgjithshëm, koeficienti Kn është:

- 0,95 për radio muzikore-biseduese të formatit të përgjithshëm,
- 1 për radio muzikore të formatit të përgjithshëm,

Te radiot biseduese-muzikore dhe ato muzikore të formatit të përgjithshëm, koeficienti Kn është:

- 1,45 për radio muzikore-biseduese të formatit të specializuar,
- 1,50 për radio muzikore të formatit të specializuar,

V. DISPOZITAT PËRMBYLLËSE

Neni 22

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore pushon vlefshmëria e Rregullores për formatet e shërbimeve programore të radios dhe atyre televizive ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 113/06,130/06 и 61/07).

Neni 23

Në procedurën për ndryshimin e lejeve ekzistuese për kryerjen e veprimtarisë radiodifuzive me leje të reja për emetim televiziv dhe të radios sipas kushteve të përcaktuara në Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, të përcaktuar në nenin 154 paragrafi 2 i këtij ligji, radiodifuzerët do të duhet që ta harmonizojnë formatin e shërbimit të tyre programor me dispozitat e kësaj Rregullore.

Neni 24

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e ardhshme pas ditës së publikimit në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë"

**Agjencia për shërbime
mediatike audio dhe audiovizuele**

Kryetar i Këshillit

Lazo PETRUSHEVSKI, d.v

Nr. 01-5776/1
21.11.2014
S h k u p